

**Njoftim i përqendrimit me të cilin ALFI PE d.o.o. fond i specializuar i investimeve k.d. Lubjana, Slloveni, do të fitoj kontrollin mbi VEMO TRADE, shoqëri tregtare për prodhim, tregti dhe shërbime SHPK, Koprivnica, Republika e Kroacisë**

**(lënda nr. 08-59/2023)**

Në përputhje me nenin 15 të Ligjit për mbrojtjen e konkurrencës ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 145/10, 136/11, 41/14, 53/16 dhe 83/18), më 31.03.2023, në Komisionin për Mbrojtjen e Konkurrencës është dorëzuar njoftim për përqendrim me të cilin shoqëria ALFI PE d.o.o. fond i specializuar i investimeve k.d. me seli në rrugën Verovshkova 55A, 1000 Lubjanë, Slloveni synon të fitoj kontrollin mbi VEMO TRADE, shoqëri tregtare për prodhim, tregti dhe shërbime SHPK me seli në rr. Ivan Gjurkan nr. 9, Koprivnica, Republika e Kroacisë.

**Pjesëmarrësit në përqendrim dhe aktivitetet e tyre të biznesit:**

ALFI PE d.o.o. Fond i specializuar i investimeve k.d., është një fond kapitali privat dhe është një fond i pavarur i kapitalit privat me një potencial investimi prej rreth 70 milionë euro. Fondi fokusohet në investimin në zhvillim të ndërmarrjet e vogla dhe të mesme inovative dhe me rritje të shpejtë të klasit të parë dhe të mesëm të themeluara ose që kryejnë biznesin e tyre kryesisht në Slloveni dhe Kroaci.

Veprimtaria e regjistruar e Shoqërisë është: veprimtaria e kujdestarisë dhe fondeve të tjera dhe subjekteve të tjera financiare.

ALFI PE d.o.o. Fond i specializuar i investimeve k.d., punon në kuadër të programit slloven të investimeve për rritjen e kapitalit. Bëhet fjalë për një program investimi në kapital në vlerën 100 milionë euro, të cilin Banka SID dhe Fondi Evropian i Investimeve (EIF) e themeluan në nëntor të vitit 2017.

Qëllimi i programit është mbështetja pronësore e ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme inovative dhe me rritje të shpejtë sllovene, firmat me kapital të mesëm me deri në 3000 të punësuar dhe hapjen e vendeve të reja të punës në Slloveni. Programi mbështetet nga Fondi Evropian për Investime Strategjike (EFSI), i cili është thelbi i Planit të Investimeve për Evropën (<https://www.sid.si/velika-podjetja/osnovneinformacije-o-segip>).

Grupi ALFI aktualisht ka 2 shoqëri të lidhura në Republikën e Maqedonisë së Veriut:

- Shoqëria për tregti dhe shërbime APOLLO MK SHPKNJ Shkup, me seli në bul. Kiro Gligorov nr. 13 Shkup, me veprimtarinë: tregtia me shumicë e mallrave të tjera për amvisëritë, dhe

- Shoqëria për shërbime PRO KOLEKT SHPKNJ Shkup, me seli në rr. Hristo Tatarçev nr. 121-G Shkup, me veprimtarinë e agjencive për mbledhjen dhe pagesën e llogarive dhe zyrave të kreditit.

Veprimtaria e regjistruar e VEMO TRADE, shoqëri tregtare për prodhim, tregti dhe shërbime SHPK është prodhimi i letrës dhe kartonit të valëzuar dhe paketim nga letra dhe kartoni, por në fakt merret me prodhimin e qeseve prej letre dhe nuk prodhon qese prej letre.

VEMO TRADE, shoqëria tregtare për prodhim, tregti dhe shërbime SHPK nuk është e pranishme në tregun maqedonas.

Parashtruesi konsideron se tregu i produktit përkatës është tregu i prodhimit të qeseve të letrës.

*Në bazë të shqyrtimit paraprak, Komisioni konstatoi se përqendrimi në fjalë mund të bie nën dispozitat të Ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës. Megjithatë, vendimi përfundimtar për këtë çështje është i rezervuar.*

*Komisioni fton palët e treta të interesuara të paraqesin vërejtjet dhe mendimet në lidhje me këtë përqendrim te Komisioni. Vërejtjet dhe mendimet e palëve të treta të interesuar mund të dërgohen edhe me faks: 02 3296 466, në adresën: rr. Shën Kirili dhe Metodi nr. 54, Shkup ose me email: kzk@kzk.gov.mk dhe të njëjtat duhet të arrijnë te Komisioni në afat prej 10 ditëve nga dita e publikimit të këtij njoftimi.*

**05.04. 2023**

**Shkup**